

V E N D I M
Nr. 305, datë 27.6.2002

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
TË INSTAT-IT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet "specialist", "përgjegjës sektori", "drejtor drejtorie" dhe "drejtor i përgjithshëm" në Drejtorinë Qendrore të INSTAT-it caktohen sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1 - diplomë e shkollës së lartë, është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Në lidhjen II-4/1 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse, emërtesa "Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it" shfuqizohet.

7. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2002 për INSTAT-in.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

LIDHJA NR. 1

Emërtimi	Paga mujore			
	Paga individuale			Shtesa e pozicionit
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
	1	2	3	4
Drejtor i Përgjithshëm	9 000	2%	0	90 000
Drejtor Drejtorie	9 000	2%	0	74 000
Përgjegjës sektori	9 000	2%	0	40 000
Specialist	9 000	2%	0	20 000